



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 77/17
Prishtinë, më 25.01.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Naser Osmani, Shukri Buja, Jelena Bontić dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Guvernator i BQK-së, Avdullah Hoti - Ministër i Financave, Enis Spahiu – nga Ministria e Financave.

Pjesëmarrësit tjerë: Bleart Maliqi-LUV, Albert Spahiu- GE, Sanije Jusufi – Gazetare nga Koha Ditore, Fjolla Uka –Monitoruese nga KDI, Blerta Bejtullahu – nga Zyra e BE-së në Kosovë–Rejhane Zylfijaja nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit.

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 21.12.2016, 22.12.2016 dhe 30.12.2016;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Janar-Mars 2017;**
- 5. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016;**
- 6. Miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2017;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetare e parë e Komisionit- njoftojë së në mungesë të kryetarit, do të kryesojë mbledhjen. Rendin e ditës e keni marr me kohë dhe propozojë për miratim.

Shipe Pantina – propozojë që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër. Ne ende nuk e kemi marrë raportin e grupit punuese që ka pas detyrë të bëjë vlersimin për buxhetin se si është shpenzuar me herët. Siq dhe kemi ra dakord që në vitin 2017, Bordi i RTK-së duhet bashkë me komisionin me e hartue buxhetin. Pra kërkojë që fillimisht ta pranojmë raportin e grupit punues, pastaj të shqyrtojmë programin e shpenzimeve. Si rrjedhojë kjo pikë duhet të shtyhet në një mbledhje tjetër të komisionit.

Besa Gaxherri – sa i përket pikës së katërt unë sot e kam marrë materialin dhe nuk e di kur është shpërndarë por është dashtë të njoftohemi në formë elektronike. Si rezultat kërkojë që kjo pikë të shtyhet në një mbledhje tjetër.

Zëvendëskryetare e parë e Komisionit- sa i përket materialeve ato janë shpërndarë me kohë dhe nëse ka pas dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë kërkesë rreth rendit të ditës ka pasur mundësi me email të kërkojë nga stafi i administratës. Siq e dijme buxheti i RTK-së është miratuar së bashku me Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017 dhe në bazë të ligjit para qdo tremujori ne shqyrtojmë programin e shpenzimeve të RTK-së dhe raportin tremujor dhe nxjerrim rekomandim për Ministrin e Financave për transferin e mjeteve në llogarinë zyrtare të RTK-së. Nuk shoh shumë të arsyeshme me e shty këtë pikë pasi që ne e bllokojmë punën televizionit sepse punëtorët duhet ti marrin pagat. Programi i shpenzimeve kësaj here ka ardhur me i detalizuar se si planifikojnë ti shpenzojnë mjetet.

Besa Gaxherri – RTK ka shumë probleme dhe ne nuk mundemi me kalue kështu shpejtë e shpejtë. Mjetet janë ndarë me miratimin e buxhetit por ne jemi komisioni përgjegjës dhe do ta përcjellim punën e RTK-së. Grupi punues ka analizuar buxhetin tremujorin e fundit të vitit të kaluar dhe kemi gjetur shumë probleme në këtë medium dhe prandaj ne duhet më shumë kohë me i analizuar dhe shqyrtuar mirë shpenzimet e planifikuar dhe prandaj kërkoj me e shty këtë pikë në mbledhje tjetër.

Sali Morina – theksi se materialin e kemi pranuar me kohë dhe kemi pasur mundësi me analizuar dhe të jemi të përgaditur sot. Megjithatë meqë ka propozime me shtye këtë pikë, duke ditur kohën e shkurtër dhe nevojën për shpërndarjen e pagave për punëtorët e RTK-së, ne duhet ta caktojmë një mbledhje të të premtën ose më në fillim të javës së ardhshme për këtë qështje.

Envere Hoti- këtu po bëhet fjalë për një pikë që e kemi trajtuar disa herë, edhe une pajtohem plotësisht me znj. Gaxherri që si grup punues kemi hasur shumë probleme në punën e RTK-së. Kemi hasur probleme me numrin e të punësuarve me një listë të stërngarkuarvhtë punësuar pa asnjë kriter. Ne kemi biseduar edhe me herët që komisioni pa prezencën e RTK-së ta trajtojë punën që ka bërë grupi punues e mandej ta thërrasim përfaqësuesit e RTK-së dhe ti diskutojmë disa qështje qe janë nevojë urgjente dhe me e ditë se qka po ndodh me këtë medium publik dhe mbështesë kërkesën e deputetëve për me shtye pikën e katërt në një mbledhje tjetër të komisionit.

Labionotë Demi- Murtezi - ndoshta është në llojë vërejtje puna e raportimit të grupit punues por duket ditur natyrën e ndjeshme të punës dhe qështjes për trajtim unë mendojë që duhet pasur respekt për punën grupit dhe të presim raportin e tij. Materiali ka mundur të shpërndahet të hënën, por ne kemi pasur edhe prioritete tjera dhe kjo qështje kërkon më shumë kohë për analizë dhe trajtim. Prandaj, propozimet për shtyrjen e kësaj pike për disa ditë janë të arsyeshme.

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit – meqë kemi një propozim për heqjen e pikës së katërt të rendit të ditës, e hudhë në votim propozimin.

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 2 Kundër dhe asnjë Abstenim, vendosi që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të komisioni.

Rendi i ditës u miratuar pa pikën katërt. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 21.12.2016, 22.12.2016 dhe 30.12.2016

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit – konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhje të mbajtura dt. 21.12.2016, 22.12.2016 dhe 30.12.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit – për këtë pikë të rendit të ditës ne kemi ftuar ministrin e financave dhe prezent është edhe Guvernatori i BQK-së dhe ua kalojë fjalën që të prezantojnë projektligjin dhe pastaj është mundësia e deputetëve për të paraqitur mendimet e tyre.

Bedri Hamza- propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjitë për Bankën Qendrore ndërlidhen me rekomandimet e FMN-së për masat mbrojtëse dhe përmirësimi në termin e kornizës qeverisëse kontrolluese të Bankës Qendrore. Ligji për Bankën Qendrore për Republikën e Kosovës, paragrafi 2 i nenin 63 parasheh emërimin e auditorëve të jashtëm nga Bordi i Bankës Qendrore pas aprovimit e Komisionit për mbikqyrjen e financave publike. Rekomandimi i FMN-së është për heqjen e dispozitës e cila kërkon aprovim nga komisioni me qenë se nje dispozitë e tillë nuk është në pajtim me nenin 27 pika 1 të statutit të sistemit evropian të bankave qendrore dhe kjo ndikon në autonominë e Bankës Qendrore ne përzgjedhje te auditorëve të jashtme. Neni 42 paragrafi 5 i Ligjit të BQK-së parasheh ne mënyre eksplicite të drejtën e zëvendësguvernatorëve qe te ankohen kundër vendimit per shkarkimine e tyre ne gjykatën supreme në rast, mirëpo nuk parasheh të njëjtën të drejtë edhe për guvernatorin edhe për anëtarët e bordit të bankës qendrore. Rekomandimi i FMN-së është që në Ligjin e Bankës Qendrore, nenin 41 të rregullohet në mënyrë eksplicite që e drejta e ankesës të jetë për guvernatorin dhe anëtarët e bordit në rastet e shkarkimit nga detyra. Një e drejtë e tillë është në pajtim me nenin 14 të statutit të sistemit evropian të bankave qendrore. Këto rekomandime janë edhe pjesë që dalin nga marrëveshja e FMN-së me Qeverinë e Kosovës.

Shqipe Pantina- kamë një vërejtje tek momerandumi shpjeguese që ka bëjë më shumë tek gjuha qe duket teknike por kur e lexon me vëmendje të krijon një ndjenjë jo të mirë, si psh. tek pika 3 opcioni i vetëm është miratimi i projektligjit. Memorandumi shpejgues është i rëndësishëm sepse të jep pasqyrën se qfarë po ndryshohet. Po ashtu do të duhej të jepen informacione për propozimet e institucioneve që janë bërë për këtë projektligj dhe nëse janë marrë parasysh dhe duke dhënë një arsytim pse nuk janë marrë parasysh. Sa përket dy nenve që janë propozuar në projektligj, ne jemi dakord me nenin e parë të propozuar që ka të bëjë me drejtën e ankesës se guvernatorit por duhet te specifikohet se kjo duhet kryhet në bazë të procedurave të konfliktit administrativ. Për propozimin e dytë nuk jemi dakord sepse me Kushtetutë Kuvendi është organ mbikëqyrës për BQK-në dhe kjo nuk nënkupton vetëm zgjedhjen e guvernatorit dhe shqyrtimin e raportit vjetor por nënkupton një mbikëqyrje të tërësishme. Lidhur me këtë nen, kam nevojë për një sqarim ku thuhet se asnjë auditor i jashtëm nuk do te emërohet në vazhdimësi për një periudhë vazhdueshme prej pesë vjetë dhe pas kësaj periudhe e firma e auditimit duhet te ndërrohet. Për mua periudha tre vjeqare është në rregul dhe periudha pesë vjeqare siq është propozuar lenë hapësirë që mandej relacionet mes kompanisë dhe bordit me u forcue dhe krijon hapësirë për keqpërdorime. Gjithësesi nuk jam me heq rolin e Kuvendit, në këtë rast të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike në përzgjedhjen e auditorit të jashtëm.

Bedri Hamza - nuk mundet me eliminue askush rolin e mbikëqyrjes së Kuvendit, dhe ky autoritet i Kuvendit bëhet qoftë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga komisionet e caktuara të Kuvendit apo edhe ne i raportojmë Kuvendit në bazë të rregullat ashtu siq e kërkon edhe ligji. Pjesë e raportit janë edhe t pasyrat financiare të audituara të cilat bëhet edhe publike. Me këtë propozime nuk po minimizohet roli i Kuvendit, por po e ritheksojë së është kërkesë nga relacionet kontraktore që kemi me FMN-në që të jemi në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të sistemit evropian të bankave qendrore, që Banka Qendrore të ketë autonominë në përzgjedhjen e auditorit të jashtëm.

Shipe Pantina - zakonisht kur bëhet një plotësim dhe ndryshim i ligjit, propozohet për shkak se neni aktual paraqet një pengesë në zbatim apo kanë ndryshuar rrethanat. Ju po thoni se nuk ka pasur pengesë sipas legjislacionit aktual dhe për mua është e pakuptimtë diqka që ka funksionuar mirë të ndryshohen procedurat. Përndryshe jam që Kuvendi duhet me pas ndikim më të madhë sidomos ndaj insitucioneve të cilat janë përgjegjëse ndaj tij.

Avdullah Hoti - me këtë projektligj janë dy ndryshime shumë të thjeshta që nuk vin si rezultat i vështërsive që ka has Banka Qendrore por përkundrazi janë obligime që ka shteti i Kosovës si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes me FMN-në. Po ashtu ndryshimet e propozuara janë në pajtim me praktikat ndërkombëtare dhe sistemin evropian të bankave qendrore.

Sali Morina- do të ishte mirë që rekomandimet për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit ti kemi në formë të shkruar nga ministria e financave, dhe pas sqarimeve të ofruara, propozojë që të përkrahim në parim projektligjin dhe pastaj kemi mundësi për shqyrtim në komision.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit, konstatoi se komisioni me katër vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në lexim të parë Projektligjin Nr.05/L-150 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

4. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2016

Safete Hadergjonaj- në raportin e punës është një përmbledhje e punës së komisionit. Janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e komisionit, si dhe aktivitetet dhe puna e kryetarit.

Shipe Pantina – unë nuk kam vërejtje në prezantimin e aktiviteteve, mirëpo kam vërejtje në punën e komisionit. Një nga obligimet e komisioneve është edhe konsultimi i publikut në hartimin apo implementimin e ligjeve. Komisioni për buxhet nuk ka organizuar anjë dëgjim publik dhe kjo është një vërejtje mjaftë e madhe. Vërejtja ime e dytë ka të bëjë me një ligj specifik që është Ligji për buxhetin që është mënyra e papranusheme se si Kuvendi dhe komisioni e trajton këtë projektligj në një afat kaq të shpejtë, ku janë votuar amendamentet e propozuara nga qeveria pa i parë dhe ditur përmbajtjen e tyre. Kjo praktikë e shqyrtimit të buxhetit duhet përfunduar njëherë e mirë.

Safete Hadergjonaj- në fakt komisioni në kontinuitet në punën e vetë në vazhdimësi ka mbajtur dëgjime publike për projektligje dhe është e vërtetë se në vitin e kaluar nuk kemi bërë dëgjime publike por nuk kemi pasur ndonjë projektligj që i ka takuar grupeve të caktuara të shoqërisë. Rrethanat të cilat kemi punuar vitin e kaluar në kanë vështirësuar punën e organizimeve të tilla. Këtë vit kemi pranuar programin legjislativ ku mund të identifikojmë projektligjet që kanë të bëjnë ma shumë me grupet e interesit dhe mund të organizojmë dëgjime publike. Sa i përket buxhetit vitin e kaluar i dijmë rrethanat, por komisionit për buxhet ka një praktik të mirë të organizimit dhe strukturimit në tre grupe punuese ku analizojmë draft buxhetin dhe kërkesat buxhetore.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit, konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Vendim

Miratohet Raportit vjetor i punës së Komisionit për vitin 2016.

5. Miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2017

Safete Hadeqjonaj- në draft planin e punës janë të përfshira aktivitetet e komisionit në vitin 2017. Janë përfshirë projektligjet nga strategjia legislative në të cilat komisioni është funksional. Po ashtu aktivitetet e përbashkëta me GIZ-në. Në draft plan është lënë hapërisë për dy ligje që duhet monitoruar për emrat e të cilëve duhet të vendosim tani.

Salih Morina – pajtohem që plani i punës për vitin 2017 të miratohet dhe të procedojmë në Kryesinë e Kuvendit. Por, me qëllim të specifikimit të aktiviteteve propozojë që të organizojmë një punëtori gjatë muajit shkurt së bashku me projektin e GIZ-së.

Safete Haderqjonaj-ne kemi një Përfundim nga Kryesia e Kuvendit që deri me datën 27 janar të gjitha komisionet duhet ti miratojnë dhe dorëzojnë planet e punës. Unë propozojë të miratojmë planin në parim sot, pastaj si komision bashkarisht me GIZ e mbajmë një takim tjetër për ti detalizuar aktivitetet gjatë vitit.

Shqipe Pantina – përveq shqyrtimit të projektligjeve dhe monitorimit të asaj formës klasike, mendojë se duhet bërë aktivitete tjera që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e institucioneve tjera që i kemi në përgjegjësi. Po më pëlqen propozimi që janë planifikuar disa takime me Komisionin për mbikëqyrjen e financave publike, por duhet me planifiku edhe takime të përbashkëta edhe me Komisionin për zhvillim ekonomik për qështjet e përbashkëta. Deputeti Bardhyl Meta e ka pasur një ide që pajtohem të aplikojmë dhe ka të bëjë me trajtimin e ndërmarrjeve publike që nuk janë në gjendje të mirë dhe mos të mbesin vetëm në nivel trajtimit ne qeveri, por edhe ne si Kuvendi të trajtojmë këto tema.

Besa Gaxherri – pajtohem që të miratojmë në parim planin e punës për vitin 2017. Por që sot të marrim vendim që me diskutue dhe me i detalizuar aktivitetet që planifikojmë ti bëjmë këtë vit.

Safete Haderqjonaj- sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, unë propozojë që në pjesën e parë të vitit të jetë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për financimin e subjekteve politike. Ne kemi edhe kërkesa nga Zyra e BE-së për të rishikuar ligjin, përfshirë qështjen e auditimit. Pranda të monitorojmë këtë ligj, që të shohim sfidat dhe nevojat eventuale për ndryshimin dhe plotësimin e tij.

Enver Hoti- propozojë që ligji i dytë për mbikëqyrje të jetë Ligji për akcizën në produktet e duhanit, i cili është në procedurë dhe të jetë në pjesën e dytë të vitit.

Në bazë të propozimeve, zëvendëskryetarja e parë e komisionit, konstatoi se Komisionit njëzëri vendosi që në draft planin e punës të shtohen mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për financimin e subjekteve politike dhe Ligji për akcizën në produktet e duhanit. Komisioni po ashtu në muajin shkurt do të organizojë një punëtori të përbashkët me Projektin e GIZ-së për të detalizuar aktivitetet gjatë vitit 2017.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit, konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Vendim

Miratohet Plani vjetor të punës së Komisionit për vitin 2017, me plotësimet e bëra në komision.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit